




REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.:	Nr. prot.:
Dep. 20/DPK	01-791/14
Nr. faq:	06.03.2014
Broj stranica:	
Nr. pages:	02



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	06.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Ferki HADJA Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Ndërmarrjen Hidro-Ekonomike "Ibër- Lepenc"
CC:	z. Hajdar BEQA Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Hidro-Ekonomike "Ibër- Lepenc"
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Kontrollimi teknik i automjeteve të IL-së"



I nderuari z. HADJA,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Kontrollimi teknik i automjeteve të IL-së" me nr. të prokurimit: IL 14010 236, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Kontrollimi teknik i automjeteve të IL-së" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Departamenti i Prokurimit në Ndërmarrjen Hidro-Ekonomike “Ibër- Lepenc” ka përgatitë “Njoftimin për Kontratë” me titull "Kontrollimi teknik i automjeteve të II.-së“ me nr. prokurimi: IL14010236, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 28.02.2014, në procedurën e kuotimit të çmimeve. Agjencia Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë aktivitet prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të këtij aktiviteti të prokurimit në “Njoftimin për Kontratë”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në “Njoftimin për Kontratë” të publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, më datë 28.02.2014, tek pika III.2.4 e rubrikës “Kapaciteti teknik dhe profesional”, pika 1. është kërkuar që Kompania duhet patjetër të jetë nga territori i Komunës së Prishtinës duke qenë se selia e NH “Ibër Lepenc” është në Prishtinë, pikë kjo e cila konsiderojmë se bie ndesh me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues Ibër Lepenc me formulimin e këtij kriteri tek pika 1.e “Njoftimit për Kontratë” ka bërë Diskriminim territorial në kundërshtim me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik ku thuhet se “Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik“.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me, nenin 7 Barazia në Trajtim Jo-Diskriminimi të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !